



A.nr.605/2026

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Argjenda Sherifi- në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës A.nr.605/2026, të datës 08.06.2026, të parashtruar nga ankuesi E.S, nga Dragashi, kundër Njoftimit të datës 14.05.2026, të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Prizrenit, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, më datë 30.06.2026 mori:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e parakohshme ankesa me numër A.nr.605/2026, e datës 08.06.2026 e parashtruar nga ankuesi E.S.

A r s y e t i m

Kandidati për pranim në shërbimin civil E.S (*në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi*), me datë 08.06.2026, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e regjistruar nën shenjë A.nr.605/2026, kundër Njoftimit të datës 14.05.2026, të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Prizrenit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 11.06.2026 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Prizrenit, ndërsa, kjo e fundit, më datë 18.06.2026, ka dorëzuar përgjigjen në ankesë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë ka gjetur se ankesa është e parakohshme *sepse*:

Kolegji i Këshillit nga administrimi i shkresave të lëndës ka konstatuar se Komuna e Prizrenit, më datë 31.03.2026, ka shpallë konkursin me numër reference: RN00019541, Grupi i Inxhinierisë së Ndërtimit, pozita e punës *Inspektor Ndërtimi*, ku afati për aplikim ka qenë nga data 01.04.2026 deri më 30.04.2026.

Tutje, nga provat material të kësaj çështje rezultoi se ankuesi ka aplikuar në këtë konkurs mirëpo më Njoftimin të datës 14.05.2026, të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Prizrenit, i është

refuzuar aplikacioni me arsyetimin se: ... *nuk plotëson kriteret e përgjithshme të konkursit, respektivisht sipas pikës 3 dhe 5, lidhur me përvojën e punës: Së paku 2 (dy) vite përvojë pune në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punë si dhe pika 5 kopjet e dëshmisë së punësimit (vërtetimi/kontratë) të lëshuar nga institucioni përkatës i punësimit për përvojën e punës, që përcakton pozitën e punës si dhe kohëzgjatjen e angazhimit në atë pozitë e cila nuk është mbështetur me dokumente përkatëse sipas kërkesave në konkurs.*

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshill, pretendon se procesi i vlerësimit nuk ka reflektuar në mënyrë të drejtë dhe objektive për përgatitjen e tij profesionale dhe përvojën e punës. Kërkon nga Këshilli rishqyrtim të plotë të procedurës së vlerësimit dhe verifikimit të respektimit të parimeve të ligjshmërisë, transparencës, barazisë dhe meritokracisë gjatë procesit të rekrutimit.

Në kuptim të pranushmërisë së ankesës, Kolegji i Këshillit, iu referua dispozitave të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë gjegjësisht, nenit 39, paragrafi 12 i cili përcakton se: “12. Kandidatët/ët e pakënaqur me procesin e rekrutimit, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare kanë të drejtë ankese në KPMSHCK sipas afatit të përcaktuar në ligjin përkatës për procedurën administrative”, si dhe nenit 17 të Rregullores 07/2025 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, me të cilin shprehimisht parashihet se: “Kandidatët e pakënaqur me procesin e rekrutimit, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare kanë të drejtë ankese në KPMSHCK në afat prej tridhjetë (30) ditëve”, dhe rrjedhimisht konstatoi se ankesa e ankuesit e parashtruar më datë 08.06.2026, kundër refuzimit të aplikacionit për pozitën e lartcekur është e parakohshme, ngase, me dispozitat përkatëse ligjore, kandidati për pranim në Shërbimin Civil ka të drejtë të parashtroj ankese vetëm pas shpalljes së rezultateve përfundimtare të procedurës së caktuar të rekrutimit, ndërsa, ankuesi në rastin konkret ka parashtruar ankese në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kundër njoftimit për refuzim të aplikacionit si veprim procedural në fazën e shqyrtimit paraprak. Pra, meqenëse në kohën e parashtrimi të ankesës së ankuesit të datës 08.06.2026, nuk kishte përfunduar procedura e pranimit sipas konkursit me Nr. Ref: RN00019541, fakt ky i konfirmuara edhe përmes përgjigjes në ankese të datës 18.06.2026, të Komunës së Prizrenit, rrjedhë se ankesa e ankuesit A.nr.605/2026, e datës 08.06.2026 është e parakohshme dhe për rrjedhojë e njëjta është e palejueshme në kuptim të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, në ndërlidhje me nenin 39, paragrafi 12 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë.

Lidhur me të drejtën në mjete juridike, Kolegji i Këshillit thekson faktin së hedhja poshtë si parakohshme e ankesës nuk mohon të drejtën e ankuesit që të kundërshtoj ligjshmërinë e refuzimit të aplikacionit pas shpalljes së rezultateve përfundimtare si akt mbi përfundimin e konkursit lidhur me pozitën përkatëse. Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Ky vendim hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Administrative në Prishtinë- Departamenti për Konteste të Punës, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

A.nr.605/2026

Argjenda SHERIFI

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj-DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- *Ankuesit E.S;*
- *Komunës së Prizrenit (Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore), si dhe;*
- *Arkivit të KPMSHCK-së.*